

20181643007

## LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR INSPEKSION FINANCIAR NË SEKTORIN PUBLIK

### Neni 1

Në Ligjin për inspeksion financiar në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 82/13, 43/14 dhe 153/15), në nenin 1 pas fjalës "rregullohen" shtohet fjala "qëllimet".

### Neni 2

Në nenin 6 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Me punën e Sektorit udhëheq kryeinspektori financiar (në tekstin e mëtejme: kryeinspektori) i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë i përgjigjet ministrit të Financave".

### Neni 3

Neni 7 ndryshohet si vijon:

"(1) Inspeksionin financiar e kryen inspektori për financa publike (në tekstin e mëtejme: inspektori financiar).

(2) Inspektori financiar kryen inspeksion financiar në bazë të autorizimit të nënshkruar nga kryeinspektori."

### Neni 4

Neni 8 ndryshohet si vijon:

"Kryeinspektori i kryen punët si vijojnë:

- udhëheq me punën e Sektorit,
- e mbikëqyr realizimin e aktiviteteve inspektuese,
- i kontrollon kërkesat, informatat ose fletëparaqitjet nga neni 10 i këtij ligji dhe në bazë të rrezikut të përcaktuar lëshon autorizim për fillimin e inspeksionit financiar,
- propozon udhëzime metodologjike dhe doracakë për realizimin e aktiviteteve inspektuese të cilat i miraton ministri i Financave,
- angazhon persona profesionistë të jashtëm në kushte dhe procedura të përcaktuara në aktin intern,
- i përcakton nevojat për trajnim të inspektorëve financiarë dhe i koordinon programet relevante për trajnim dhe
- bashkëpunon dhe shkëmben informata me subjekte tjera nga sektori publik si dhe institucione tjera ndërkombëtare relevante."

### Neni 5

Në nenin 9 paragrafin (1) alineja 5 ndryshohet si vijon:

- "parashtron kërkesa për ngritjen e procedurës kundërvajtëse, përkatësisht penale dhe kërkesë pronësore juridike për kryerësit, kur ekzistojnë parakushte ligjore,".

### Neni 6

Neni 12 ndryshohet si vijon:

"(1) Kryeinspektori dhe inspektorët financiarë kanë status të nëpunësve administrativë.

(2) Titujt e inspektorëve financiarë janë inspektor i ri, inspektor, inspektor i lartë dhe ndihmëskryeinspektor kryesor dhe kryeinspektor kryesor.

(3) Inspektor i ri mund të jetë nëpunësi i cili i plotëson kushtet për titullin bashkëpunëtor i lartë nga Ligji për nëpunës administrativë. Inspektori i ri mund të marrë pjesë në punën e ekipit inspektues, por nuk mundet në mënyrë të pavarur të zbatojë inspeksion financiar.

(4) Inspektor mund të jetë nëpunësi i cili i plotëson kushtet për titullin këshilltar nga Ligji për nëpunës administrativë.

(5) Inspektori i lartë mund të jetë nëpunësi i cili i plotëson kushtet për titullin udhëheqës i seksionit nga Ligji për nëpunës administrativë.

(6) Ndhimëskryeinspektor mund të jetë nëpunësi i cili i plotëson kushtet për titullin ndihmësudhëheqës i sektorit nga Ligji për nëpunës administrativë.

(7) Kryeinspektor mund të jetë nëpunësi i cili i plotëson kushtet për titullin udhëheqës sektori nga Ligji për nëpunës administrativë.

(8) Aktvendimet për përcaktimin e titujve nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni i miraton ministri i Financave.

(9) Kryeinspektori dhe inspektorët financiarë kanë të drejtë të shtesës së rrogës, në shumë prej 30% nga shuma e rrogës bazë.“.

#### Neni 7

Pas nenit 12 shtohet nen i ri 12-a, si vijon:

#### "Neni 12-a

Në Sektor përcaktohen edhe vendet e punës për kryerjen e punëve profesionale administrative me tituj bashkëpunëtor i ri dhe bashkëpunëtor.”.

#### Neni 8

Neni 13 ndryshohet si vijon:

“Kryeinspektor mund të emërohet personi i cili i plotëson kushtet si vijojnë:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- nuk i është shqiptuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- ka marrë së paku 240 kredi sipas SETK ose ka mbaruar shkallën VII/1 fakultetin ekonomik ose juridik,
- së paku pesë vjet përvojë pune në sferën e financave ose revizionit të brendshëm ose të jashtëm, prej të cilave të paktën dy vjet në vend pune udhëheqës në sektorin publik, përkatësisht së paku tetë vjet përvojë pune në sferën e financave ose revizionit të brendshëm ose të jashtëm prej të cilave të paktën tre vjet në vendin udhëheqës të punës në sektorin privat,
- njohje aktive të njërës nga tri gjuhët më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht), njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, provim të dhënë për menaxhim administrativ dhe kompetenca tjera specifike të punës të përcaktuara në aktin për sistematizimin e vendeve të punës për vendin e punës përkatës dhe
- ka licencë për inspektor financiar.”.

#### Neni 9

Pas nenit 13 shtohen tre nene te reja 13-a, 13-b, 13-v si vijojnë:

#### "Neni 13-a

Inspektor financiar mund të jetë person i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- nuk i është shqiptuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- ka marrë së paku 240 kredi sipas SETK ose ka kryer shkallën VII/1 në fushën e shkencave ekonomike ose juridike,

- i plotëson kushtet tjera të parashikuara në aktin për sistematizimin e vendeve të punës,
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht), njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe kompetenca të tjera specifike të punës të përcaktuara në aktin për sistematizimin e vendeve të punës për vendin përkatës të punës dhe
- ka licencë për inspektor financiar.

#### Neni 13-b

(1) Ndhimëskryeinspektori dhe inspektori i lartë, krahas kushteve nga neni 13-a të këtij ligji duhet të kenë katër vjet përvojë pune në fushën e financave ose të revizionit të brendshëm ose të jashtëm prej të cilave së paku një vit në vendin e punës në sektorin publik, përkatësisht së paku gjashtë vjet përvojë pune në fushën e financave ose revizionit të brendshëm ose të jashtëm prej të cilëve së paku dy vjet në vend pune udhëheqës në sektor privat.

(2) Inspektori krahas kushteve nga neni 13-a të këtij ligji duhet të ketë tre vjet përvojë pune në fushën e financave ose të revizionit të brendshëm ose të jashtëm.

(3) Inspektori i ri krahas kushteve nga neni 13-a të këtij ligji duhet të ketë dy vjet përvojë pune në fushën e financave ose të revizionit të brendshëm ose të jashtëm.

#### Neni 13-v

(1) Për marrjen e licencës për inspektor financiar, kandidati jep provim për inspektor financiar.

(2) Kusht për dhënien e provimit për inspektor është kandidati të ketë së paku dy vjet përvojë pune në financa ose revizion të brendshëm ose të jashtëm pas diplomimit.

(3) Provimi zbatohet sipas Programit për mënyrën e dhënies së provimit për marrjen e licencës për inspektor financiar.

(4) Programin nga paragrafi (3) i këtij neni e miraton ministri i Financave.

(5) Provimin për inspektor financiar e zbaton Ministria e Financave.

(6) Licencën për inspektor financiar e lëshon ministri i Financave.

(7) Licenca nga paragrafi (2) është me vlefshmëri prej pesë vitesh.

(8) Gjashtë muaj para skadimit të vlefshmërisë së licencës, inspektori përsëri e jep provimin.

(9) Provimin nga paragrafi (3) i këtij neni inspektori ka të drejt ta mbajë dy herë, e më së voni deri në skadimin e vlefshmërisë së licencës ekzistuese.

(10) Inspektori financiar që nuk do ta japë provimin sistemohet në vendin e punës përkatës me titullin që e ka.

(11) Mënyrën e dhënies së provimit për inspektor, si dhe formën dhe përmbajtjen e kërkesës për dhënien e provimit dhe të licencës për inspektor, i përcakton ministri i Financave."

#### Neni 10

Në nenin 14 paragrafi (1) pas alinesë 4 shtohet aline e re 5, si vijon:

"- të kërkojë legjitimim dhe deklarata të nënshkruara me dorë të vetë në rast të parregullsive,".

Alinetë 5, 6, 7, 8 dhe 9 bëhen aline 6, 7, 8, 9 dhe 10.

#### Neni 11

Në nenin 15 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Inspektori financiar vepron ligjshëm, në kohë dhe në përputhje me Kodin etik për nëpunës administrativë dhe Kodin etik të inspektorëve."

Paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

(5) Në rast të fillimit të procedurës hetimore nga organet kompetente në subjektin e inspektuar, inspektori financiar e ndërpret marrjen e çfarëdo veprimesh me të cilat mund t'i pengojë veprimet hetimore."

#### Neni 12

Në nenin 16 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

“Subjekti në të cilin kryhet inspektimi financiar është i detyruar që inspektorit financiar t'i mundësojë kryerje të papenguar të inspektimit dhe t'i vë në shikim informatat dhe dokumentet e nevojshme për kryerjen e inspektimit, duke përfshirë:

- t'i sigurojë kushte të domosdoshme për punë të papenguar dhe për përcaktimin e gjendjes faktike dhe

- t'i mundësojë në afatin e përcaktuar qasje te lokalet, prodhimet, dokumentet ose çfarëdo mjete tjetër që është lëndë e inspeksionit financiar.“.

#### Neni 13

Neni 17 ndryshohet si vijon:

“Inspektorit nuk mund t'i ngarkohen punë tjera që do të jenë pengesë për kryerjen e punës së tij themelore ose në çfarëdo mënyrë do ta dëmtojnë reputacionin dhe paanshmërinë në kryerjen e funksionit të tij.“.

#### Neni 14

Neni 18 ndryshohet si vijon:

“(1) Procedurë për inspeksion financiar mund të ngitë kryeinspektori në bazë të nenit 10 të këtij ligji dhe me urdhër të ministrit të Financave.

(2) Kryeinspektori para fillimit të inspektimit financiar e njofton ministrin e Financave.

(3) Kryeinspektori vendos për fillimin e inspektimit financiar, nëse merr njoftim që sugjeron për dyshim të bazuar për menaxhim të keq serioz financiar, mashtrim dhe korrupsion.“.

#### Neni 15

Neni 19 ndryshohet si vijon:

“(1) Inspektori financiar përpilon raport për inspektimin e kryer financiar me konstatime të mbështetura me dëshmi relevante dhe propozon masa të cilat i dorëzon te kryeinspektori.

(2) Pas miratimit të raportit nga paragrafi (1) i këtij neni nga kryeinspektori, raporti i dorëzohet udhëheqësit të subjektit në të cilin është kryer inspeksioni financiar që të japë vërejtje me shkrim në afat prej 10 ditësh pune nga dita e pranimit të raportit.

(3) Në rast të parregullsive të përcaktuara, për shkak të dhënies së vërejtjeve me shkrim në afatin nga paragrafi (2) të këtij neni, kopjet nga konstatimet në raport dhe dëshmitë shoqëruese në mënyrë adekuate dorëzohen edhe te personat në subjektin aktivitetet e të cilit kanë qenë lëndë e inspeksionit.

(4) Inspektori financiar i cili e ka kryer inspeksionin, në afat prej shtatë ditësh pune nga dita e pranimit të vërejtjeve nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, përpilon raport për inspeksionin e kryer financiar në të cilin i inkorporon vërejtjet e pranuar.

(5) Pas miratimit të raportit nga paragrafi (4) i këtij neni, kryeinspektori ia dorëzon udhëheqësit të subjektit në të cilin është kryer inspeksioni financiar, si dhe personave nga paragrafi (3) i këtij neni.

(6) Udhëheqësi i subjektit në të cilin është kryer inspeksioni financiar, në afat prej 30 ditësh pas marrjes së raportit nga paragrafi (4) i këtij neni, është i detyruar me shkrim ta njoftojë kryeinspektorin për masat dhe aktivitetet e marra.

(7) Kryeinspektori raportin për inspeksionin e kryer financiar ia dorëzon ministrit të Financave për informimin e tij.“.

#### Neni 16

Në nenin 20 paragrafi (2) pas fjalëve: “nga paragrafi (1)” shtohen fjalët: “alineja 1”.

#### Neni 17

Në nenin 21 paragrafi (1) alineja 4 ndryshohet si vijon:

“- në shoqërinë tregtare në të cilën është ngritur procedurë e falimentimit ose likuidimit, informatat për parregullsitë i dorëzohen organit të administratës shtetërore ose komunës që ka të drejta pronësore dhe organeve të procedurës së falimentimit.”.

#### Neni 18

Pas nenit 22 shtohet neni i ri 22-a, si vijon:

#### "Neni 22-a

Nëse inspektori konstaton se ekziston bazë për marrjen e masave administrative dhe të tjera, për marrjen e të cilave është kompetent organi tjetër, është i detyruar që pa prolongim ta njoftojë atë organ.”.

#### Neni 19

Neni 23 ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje të kryer udhëheqësit të subjektit në të cilin kryhet inspeksion, nëse:

1) inspektorit financiar nuk i mundëson kryerjen e papenguar të inspeksionit dhe nuk i paraqet për shikim informatat dhe dokumentet të cilat janë të nevojshme për kryerjen e inspeksionit (neni 16 paragrafi (1));

2) inspektorit financiar nuk i siguron kushte të domosdoshme për punë të papenguar dhe për përcaktimin e gjendjes faktike (neni 16 paragrafi (1) alineja 1);

3) inspektorit financiar nuk i mundëson në afat të caktuar qasje te lokalet, prodhimet, dokumentet ose çfarëdo mjete tjetër që është lëndë e inspeksionit financiar (neni 16 paragrafi (1), alineja 2);

4) me kërkesë me shkrim të inspektorit financiar, në afatin e caktuar me kërkesën e inspektorit, nuk i dorëzon ose përgatit të dhëna të sakta dhe të plota, raporte, materiale ose dokumente tjera të cilat janë të domosdoshme për zbatimin e inspeksionit financiar (neni 16 paragrafi (2));

5) me urdhër të inspektorit financiar nuk kryen aktivitetet gjatë procedurës inspektuese (neni 16 paragrafi (3));

6) refuzon të japë informata nga inspeksionet financiare të kryera paraprakisht (neni 16 paragrafi (4));

7) nuk merr masa për rishqyrtimin e sistemeve për menaxhim financiar me qëllim që të hiqen parregullsitë dhe/ose të evitohen pasojat negative nga këto aktivitete (neni 20 paragrafi (1) alineja 1);

8) nuk i ndërpret aktivitetet të cilat kanë sjellë në parregullësi ose kanë shkaktuar dëm (neni 20 paragrafi (1) alineja 2);

9) nuk i harmonizon aktet interne me rregullativën për menaxhim dhe kontroll financiar (neni 20 paragrafi (1) alineja 3) dhe

10) nuk merr masa për zhdëmtim material ose masa disiplinore në pajtim me ligjin dhe nuk njofton për zbatimin e tyre në afatin e caktuar (neni 20 paragrafi (1) alineja 4).”.

#### Neni 20

Në nenin 24 paragrafi (3) fjala “kompetent” zëvendësohet me fjalën “financiar”.

Në paragrafin (5) fjalët: “paragrafi (1)” zëvendësohen me fjalët: “paragrafi (4)”.

Në paragrafin (6) fjalët: “paragrafi (2)” zëvendësohen me fjalët: “paragrafi (5)”.

Neni 21

Në nenin 25 pas paragrafit 1 shtohet paragrafi i ri 2, si vijon:

“Zbatimi i nenit 13 paragrafi (1) alineja 6 dhe nenit 13-a paragrafi (1) alineja 6, do të fillojë gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.”.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.